

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial  
**Zgjidhjet**

**P2**

FLETË PROVIMI

Data 30.09.2017

**PËRMBAJTJA**

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u></b>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problem 5	20	
<b>Total</b>	100	

## Problemi 1

- a. Detalet e kostove të ndërlidhura me produktin A janë si më poshtë :

€

Materialet Direkte	8.00
Puna Direkte	1.20
Shpenzimet tjera direkte	0.75
Shpenzimet e përgjithshme	2.18

Sa janë kostot direkte ( kryesore ) për njësi të produktit A ? (5 pikë)

- b. Kompania Bardha aplikon sistemin e bonuseve për rritjen e produktivitetit. Janë dhënë detalet në lidhje me pagën për një punëtor:

Pagesa për punëtor €9 për orë.

Koha e lejuar për të përfunduar një punë 40 minuta

Koha që aktualisht u përfundua një punë 25 minuta

Kompania e kalkulon bonusin për punëtorin në 45% të kohës së kursyer në punë.

Kalkuloni bonusin që fiton punëtori për një punë. ( Rrumbullakos vlerat ) (7 pikë)

- c. Verdha Co. ka informatat e mëposhtme në lidhje me nivelin e njërive dalëse dhe shpenzimeve të përgjithshme.:

	Janar	Dhjetor
Njësit e prodhuara	36,000	42,000
Shpenzimet e përgjithshme	€173,600	€198,660

Kostot rriten për 5% nga Janari deri në Dhjetor. Kalkuloni kostot variabile për njësi dhe fikse për Janar dhe kostot fikse për Dhjetor sipas metodës Lart/Poshtë ( rrumbullakos vlerat): ( 8 pikë)

## Zgjidhja 1

a.

$$\text{Kostot direkte} = 8 + 1.2 + 0.75 = 9.95$$

( 0.5 + 0.5 + 4) = 5 pikë

b.

$$\text{Koha e kursyer} = 40 - 25 = 15 \text{ minuta} \quad (1 \text{ pikë})$$

$$\text{Bonusi në minuta} = 15 * 0.45 = 6.75$$

minuta (3 pikë)

$$\text{Bonusi në vlerë} = 6.75/60 \times \text{€}9 = \text{€}1.01$$

( 3 pikë)

c. Kostot e Dhjetorit para rritjes = €198,660/1.05 = €189,200 ( 2 pikë)

	Njësit	Shp. përgjithshme
Janar	36,000	€173,600
Dhjetor	<u>42,000</u>	<u>€189,200</u>
Ndryshimi	<u>6,000</u>	€15,600 ( 1 pikë)

$$\text{Kostoja Variabile për njësi} = \text{€}15,600/6,000 \text{ njësi} = \text{€}2.60 \text{ për njësi} ( 1 \text{ pikë} )$$

$$\text{Kostot fikse në Janar} = 173,600 - ( 2.6 \times 36,000 ) = 80,000\text{€} ( 1 \text{ pikë} )$$

$$\text{Kostot fikse në Dhjetor} = 80,000 + (198,660 - 189,200) = 89,460 \quad (3 \text{ pikë})$$

## Problemi 2

Kompania IBA ka transaksionet e mëposhtme për vitet që përfundojnë:

	31 Mars 2016	31 Mars 2015
Shpenzimet e përgjithshme fikse		
të buxhetuara të prodhimit vjetore	€105,625	€105,625
Shitjet (njësi)	350,000	319,500
Stoqet në fillim (njësi)	19,500	18,000
Stoqet në fund (njësi)	22,000	19,500

Materiali Direkt (për njësi)

- Teli €0.08
- Unazat lidhëse €0.12

Puna direkte:

4 minuta për njësi @ €9 për orë

Shp. Variable të përgjithshme: 10% e punës direkte

Produkti shitet me çmim prej €1.95. Kostoja e materialit direkt dhe punës direkte nuk është rritur përgjatë periudhës dy vjeçare.

Kostot fikse të përgjithshme të prodhimit absorbohen në bazë të njësive të prodhimit duke vlerësuar kapacitetin operativ të kompanisë prej 65% të kapacitetit maksimal (kapaciteti maksimal 500,000 njësi). Kostot fikse të përgjithshme të prodhimit aktuale janë të barabarta me vlerën e buxhetuar.

### KËRKOHET:

- Llogariteni koston fikse për njësi, nën/mbi absorbimin e kostove për dy periudhat, koston e produktit për njësi sipas trajtimit të absorbimit të kostove dhe trajtimit variabil. (6 pikë)
- Përgatiteni pasqyrën e të ardhurave për vitet që mbarojnë më 31 Mars 2016 dhe 2015 dhe bëni ri konsolidimin e fitimit. (14 pikë)

## Zgjidhja 2

A

**P1** *Kosto fikse për njësi*

	<b>2016 &amp; 2015</b>
Kostot totale vjetore fikse (x)	€105,625
65% kapacitetit të prodhimit (njësi) (y)	325,000
Kosto fikse për njësi (x/y)	€0.325 (2 pikë)

	<b>2016 njësi</b>	<b>2015 njësi</b>
<b>P2</b> <i>Njësit e prodhimit</i>		
Stoqet në fund	22,000	19,500
Shitjet	<u>350,000</u>	<u>319,500</u>
Total	372,000	339,000
Stoqet në fillim	<u>(19,500)</u>	<u>(18,000)</u>
Njësit e prodhuara (1 pikë)	<u>352,500</u>	<u>321,000</u>

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
<b>P3</b> <i>Kalkulimi nën/mbi aplikimit</i>	□	□
Kostot fikse të buxhetuara	105,625	105,625
Kostot fikse të absorbuara	<u>114,562.5*</u>	<u>104,325**</u>
Nën/mbi aplikimi 1 pikë	<u>-8,937,5</u>	<u>1,300</u>

- \* 352,500 x 0.325 = 114,562.5

- \*\*321,000 x 0.325 = 104,325

## P4 Kostot e produktit

### Materiali direkt

Teli	0.08
- Unazat lidhëse	0.12
Puna direkte	0.60
Sh.p. variabile 10% e punës direkte	0.06
<i>Kostoja e produktit- Trajtimi Variabil ( 1 pikë )</i>	<u>0.86</u>
<i>Kosto fikse (P1)</i>	<u>0.325</u>
<i>Kostoja e produktit – Trajtimi Absorbimit (1 pikë)</i>	<u>1.185</u>

### (b) Pasqyra e fitimit 2016 & 2015

<i>Trajtimi variabil (Kostoja e Produktit =</i>	<del>Shifra</del>	<b>2016</b>	<b>2015</b>
		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shitjet		682,500	623,025
Kosto e shitjeve:			
Stoqet në fillim		16,770	15,480
+ Prodhimi (shif P2)		303,150	276,060
- Stoqet në fund		<u>18,920</u>	<u>16,770</u>
Kosto e produkteve të shitura		<u>301,000</u>	<u>274,770</u>
Fitim Kontributi		381,500	348,255
Kostot fikse përgjithshme.		<u>105,625</u>	<u>105,625</u>
Fitimi		<u>275,875</u>	<u>242,630</u>
<i>Trajtimi Absorbimit (Kosto e produktit =</i>	<del>Shifra</del>	<b>2016</b>	<b>2015</b>
		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shitjet		682,500	623,025
Kostot e shitjes:			
Stoqet në fillim		23,108	21,330
+ Prodhimi (shih P2)		417,713	380,385
- Stoqet në fund		<u>26,070</u>	<u>23,108</u>
		<u>414,751</u>	<u>378,608</u>
nën/(mbi) aplikimi (shih P3)		-8,938	1,300
Kosto e produkteve të shitura		<u>405,813</u>	<u>379,908</u>
Fitimi		<u>276,687</u>	<u>243,118</u>

(12 pikë)

**(c) Ri konsolidimi, Variabile/ Absorbimit**

**2016 2015**

Fitimi – Trajtimi Absorbimit  
zbritur -Kostot fikse në stoqe

276,687 243,118

(19,500 - 22,000) \* €0.325

-812

(18,000 - 19,500) \* €0.325  
Fitimi – Trajtimi Variabil

275,875 -488  
242,630

(2 pike)



### Problemi 3

Kompania GG për vitin në vijim ka në total 15,000 orë makinerie dhe 20,000 orë të punës direkte në dispozicion. Prodhimi dhe shitja për produktet e kompanisë pritet të jenë si më poshtë për njësi:

	<b>Bluza</b>	<b>Këmisha</b>	<b>Setër</b>
Materiali direkt: €6 për metër	1.5 metra	1.25 metra	2.5metra
Puna Direkt: €12 për orë	0.25 orë	0.25 orë	0.5orë
Shpenzimet variabile të përgjithshme:			
150% e punës direkte (njësi)			
Orët e makinerisë të kërkuara (njësi)	0.3 orë	0.2 orë	0.25 orë
Kërkesat vjetore (njësi)	30,000	18,000	15,000
Çmimi i shitjes për njësi	€54	€80	€105

Kostot fikse të buxhetuara të përgjithshme të prodhimit janë vlerësuar të jenë €95,200 për muaj dhe gjithashtu janë buxhetuar edhe kostot e shitjes dhe administrative prej €128,000 për çdo tremujor.

#### **KËRKHET:**

- (a) Bazuar në të dhënat e mësipërme, përmes kalkulimeve tregoni sa a ka kapacitet prodhimi të mjaftueshëm kompania GG që të përmbush kërkesat e tregut. (5 pikë)
- (b) Kalkuloni planin optimal të prodhimit për kompaninë GG dhe llogariteni fitimin e pritur.

(15 pikë)

### Zgjidhje e problemit 3

#### (a) Kapaciteti I prodhimit në raport me kërkesat e tregut

	Kërkesat	Orët e kërkuara të punës	Orët tregut e kërkuara të mak.
Bluza	30,000	7,500	9,000
Këmisha	18,000	4,500	3,600
Setër	15,000	7,500	3,750
		19,500	16,350
Orët në dispozicion		20,000	15,000
Diferenca		500	-1,350

Kompania nuk ka orë të mjaftueshme makinerie për të përmbushur kërkesat (5 pikë)

#### (b) Kalkulimi i prodhimit optimal dhe fitimit të pritur

Kalkulimi i kontributit për njësi sipas faktorit kufizues – orët e makinerisë

	Bluza	Këmisha	Setër
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Çmimi I shitjes për njësi	54	80	105
Zbritur: kostot variabile për njësi			
Materiali direkt @ €6 për metër	9	7.5	15
Orët direkte @ €12 për orë	3	3	6
Shp. variabile: 150% Punës direkte	4.5	4.5	9
<u>Total Kostot variabile</u>	16.5	15	0
Kontributi për njësi (x)	37.5	65	75
Orë makinerie për njësi (y)	0.3	0.2	0.25
Kontributi për orë makinerie (x/y)	125	325	300
Renditja	3	1	2

Plani optimal i prodhimit

Llojet	Kontributi Për njësi	Prodhimi Në njësi	Orë makinerie Për njësi	Total orët e Kërk. Të mak.	Kontributi
	<input type="checkbox"/>				<input type="checkbox"/>
Këmisha	65	18,000	0.20	3,600	1,170,000
Setër	75	15,000	0.25	3,750	1,125,000
Bluza	37.5	25,500*	0.30	7,650	956,250
				15,000	
Kontributi total					3,251,250
Zbritur: kostot fikse të prodhimit					1,142,400
Shpenzimet e shitjes dhe administrative					512,000
<u>Fitimi</u>					<u>1,596,850</u>

\* Numri I bluzave që mund të prodhohet me orët e mbetura të makineris.  $15,000 - 3,600 - 3,750 = 7,650$  orë  $\times /0.3 = 25,500$  bluza

(15 pikë)

#### Problemi 4

Kompania DD operon me sistemin standard të absorbimit të kostove. Detalet e mëposhtme janë nxjerr nga raportet financiare të fundit:

<b>Kosto standard për njësi:</b>	□
Materiali Direkt	
- Druri: 1.75 m2 @ €22 për m2	38.50
- Panel : 16 copë @ €0.25 secila	4.00
Puna direkte : 0.75 orë @ €20 për orë	15.00
Shpenz. Variabile të përgjithshme: 0.75 orë @ €4.60 për orë pune direkte	3.45
: Shpenzimet fikse të përgjithshme :@ €5.10 për njësi	<u>5.10</u>
Total	66.05

Kompania ka planifikuar të prodhoj 10,000 njësi në periudhë.

#### Aktualisht kompania ka prodhuar 9,500 njësi :

Materiali Direkt	
Druri (17,100 metra katror)	€375,345
Panel (159,600 copë)	€41,496
Puna Direkte (6,650 orë)	€139,650
Shpenzimet e përgjithshme variabile	€29,925
Shpenzimet e përgjithshme fikse	€50,100

#### KËRKOHET

Nga të dhënat e mësipërme:

- (a) Përgatiteni pasqyrën e kostove për buxhetin fiks, buxhetin fleksibil dhe të rezultateve aktuale. (6 pikë)
- (b) Kalkuloni të gjitha variancat për kostot direkte, indirekte (14 pikë)

[Total: 20 pikë]

#### Zgjidhja e problemit 4

(a) Pasqyra e kostove

Njësi	10,000	9,500	9,500
	B. FIKS	B. FLEKSIBIL	Rezultati Aktual
	□	□	□
Materiali Direkt			
Druri	385,000	365,750	375,345
Panela	40,000	38,000	41,496
Puna Direkte	150,000	142,500	139,650
Shpp variabile	34,500	32,775	29,925
Shpp fikse	<u>51,000</u>	<u>51,000</u>	<u>50,100</u>
Kostot totale të prodhimit	<u>660,500</u>	<u>630,025</u>	<u>636,516</u>

(6 pikë)

(b) Kalkulimi variancave

**Materiali direkt**

*Druri*

Varianca e çmimit  $[\text{€}22 - (\text{€}375,345/17,100)] \times 17,100 = 855 \text{ f}$

Varianca e përdorimit  $[(1.75 \times 9,500) - 17,100] \times \text{€}22 = -10,450 \text{ PF}$

*Panele*

Varianca e çmimit  $[\text{€}0.25 - (\text{€}41,496/159,600)] \times 159,600 = -1,596 \text{ PF}$

Varianca e përdorimit  $[(16 \times 9,500) - 159,600] \times \text{€}0.25 = -1,900 \text{ PF}$

**Puna direkte**

Varianca e çmimit  $[\text{€}20 - (\text{€}139,650/6,650)] \times 6,650 = -6,650 \text{ PF}$

Varianca e efikasitetit  $[(0.75 \times 9,500) - 6,650] \times \text{€}20 = 9,500 \text{ F}$

**Varianca e SHPP Variabile**

Varianca e çmimit  $[\text{€}4.60 - (\text{€}29,925/6,650)] \times 6,650 = 665 \text{ F}$

efikasiteti  $[(0.75 \times 9,500) - 6,650] \times \text{€}4.60 = 2,185 \text{ F}$

**Varianca e SHPP Fikse**

Variancat në shpenzim  $[(10,000 \times 5.10) - 50,100] = 900 \text{ F}$

Varianca në vëllim  $(9,500 - 10,000) \times \text{€}5.10 = -2,550 \text{ PF}$

(14 pikë)

## Problemi 5

FF kompani prodhon një produkt në dy procese Përgatitja e Materialit dhe Finalizimi i Produktit. Informatat në vijim janë nxjerrë nga sistemi i kontabilitetit të kompanisë për periudhën që përfundon 31 Dhjetor 2016.

Në procesin Përgatitja e Materialit, materiali Y ( materiali i vetëm për prodhimin e produktit ) futet në **fillim të procesit** dhe stoqet e materialit në fillim të periudhës më 01 Janar 2016 ishin 2,500 njësi me kosto materialit 6,250€. Kosto e punës dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit në fillim të periudhës ishin €3,000. Stoqet në fillim ishin përfunduar 60%. Gjatë vitit 2016, ishin futur materiale për prodhimin e 10,000 njësive me kosto 3.6€ për njësi në procesin Përgatitja e Materialit. Kostoja e punës dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit gjatë vitit 2016 ishin 20,000€ për procesin Përgatitja e Materialit. Gjatë procesit të prodhimit Përgatitja e Materialit, 20% e njësive të materialit të futur në periudhë dëmtohet dhe kostoja e largimit është 2 € për njësi. Stoqet në fund ishin 1,500 njësi dhe përqindja e kompletimit ishte 70% për procesin Përgatitja e Materialit.

### **KËRKOHET:**

Nga të dhënat e mësipërme për procesin Përgatitja e Materialit sipas metodës FIFO dhe Mesatare kalkuloni:  
( rumbullakos vlerat në dy decimale )

- a. Njësitë ekuivalente për Materialin dhe koston e punës dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit ( 4 pikë)
- b. Koston për njësi ( 6 pikë )
- c. Koston e njësive të transferuara jashtë ( 5 pikë )
- d. Koston e stoqeve në fund të periudhës ( 5 pikë)

## Zgjidhja e problemit 5

a. FIFO Nj .ekuivalente mat. =  $\{0 + [(10,000 - 20\%) - 1,500] + 1,500\} = 8,000$  (1 pikë)

$$\text{Nj .ekuivalente puna dhe sh.p.p} = \{ (2,500 \times 0.4) + [(10,000 - 20\%) - 1,500] + (1,500 \times 0.7) \} = 8,550 \text{ (1 pikë)}$$

Mesatare Nj .ekuivalente mat. =  $\{0 + [(10,000 - 20\%) - 1,500] + 1,500\} = 8,000$  (1 pikë)

$$\text{Nj .ekuivalente puna dhe sh.p.p} = \{ (2,500 \times 0.4) + [(10,000 - 20\%) - 1,500] + (1,500 \times 0.7) \} = 8,550 \text{ (1 pikë)}$$

b. FIFO Kosto/njësi materiali =  $\{[(3,600 + (2,000 \times 2))/8,000]\} = 5$

$$\text{Kosto/njësi puna dhe shpp} = (20,000 / 8,550) = 2.34$$

$$\text{Kosto për njësi} = 5 + 2.34 = 7.34 \text{ (3 pikë)}$$

Mesatare Kosto/njësi materiali =  $\{[(6,250 + 36,000) + (2,000 \times 2)] / (2,500 + 8,000)\} = 4.40$

$$\text{Kosto/njësi puna dhe shpp} = (3000 + 20,000) / (1,500 + 8,550) = 2.29$$

$$\text{Kosto për njësi} = 4.4 + 2.29 = 6.69 \text{ (3 pikë)}$$

c. FIFO Kosto e njësive të transferuara jashtë =  $(6,500 \times 7.34) + [(6,250 + 3,000) + (1,000 \times 2.34)] = 59,300$  (2.5 pikë)

Mesatare Kosto e njësive të transferuara jashtë =  $(9,000 \times 6.69) = 60,210$  (2.5 pikë)

d. FIFO Stoqet në fund

$$\text{Materiali} = 1,500 \times 5 = 7,500$$

$$\text{Puna dhe shpp} = 1,050 \times 2.34 = 2,457$$

$$\text{Total Stoqet} = 7,500 + 2,457 = 9,957 \text{ (2.5 pikë)}$$

Mesatare Stoqet në fund

$$\text{Materiali} = 1,500 \times 4.4 = 6,600$$

$$\text{Puna dhe shpp} = 1,050 \times 2.29 = 2,405$$

$$\text{Total Stoqet} = 6,600 + 2,405 = 9,005 \text{ (2.5 pikë)}$$